

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Operatori ekonomik i licënsuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në bazë të Ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, ka disa përgjegjësi kryesore, si:

1. Të mbulojë të gjitha shpenzimet, si: pagat e rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve, shpenzimet për uniformat, ndërlidhje, si dhe gjithë kompesimet e tjera, të njohura me ligj.
2. Sigurimi i rendit dhe qetësisë në objektet që ruan duke informuar në kohë strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë publike në territorin e objektit në ruajtje;
3. Të ushtrojë kontroll të herëpashershëm të personave që hyjnë në territorin e objekteve që ruhen, si dhe automjeteve në territorin e saj;
4. Të kërkojë zbatimin e rregullave të përcaktuara nga punëdhënësi, si dhe rregulloreve të brendshme të nxjerra nga ky i fundit, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate;
5. Të informojë rregullisht në institucion për shkeljet e konstatuara;
6. Sipërmarrësi mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin jo vetëm në godinat spitalore dhe vendrojet përkatëse, por edhe në të gjitha objektet e tjera që janë pjesë e territorit të QSUT-së dhe janë objekte të QSUT-së, në territorin e objektit që ruhet nga ana e tij, si dhe në sipërfaqet e gjelbërta, kur këto vijnë si rezultat i mungesës së vigjilencës së rojeve dhe mos organizimit të mirë të shërbimit. Në këto raste sipërmarrësi detyrohet të bëjë ç’ dëmtimin e pasurisë së vjedhur apo dëmtuar në masën 100% të vlerës së dëmtuar.
7. Të marrë masat e nevojshme për sigurimin teknik në lidhje me **armët dhe municionet**, mjetet e shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi;
8. Të mos punësojë në veprimtarinë e SHPSF-së punonjës shërbimi të paçertifikuar;
9. Të përdorë aktivitetin e SHPSF-së vetëm për qëllimin për të cilin është licencuar;
10. Të ofrojë sallën operative, radiostacionin në QSUT, për monitorimin 24 orë të shërbimeve, në përputhje me nenin 22, pika 3 e ligjit “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” i cili parashikon se *“Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë”*, në QSUT, dmth radiostacioni qëndror të jetë në QSUT
11. Përqëndrimi i valëve, të jetë në një valë të vetme, ku QSUT duhet të vihet në dijeni për çdo informacion që përcillet në këtë valë;
12. Cdo vendroje të jetë e paisur me radiomarrëse.

Gjithashtu, operatori ekonomik në ushtrimin e aktivitetit të shërbimit privat të sigurisë fizike, duhet të ketë personelin kryesor si **Drejtuesin Teknik dhe Punonjësit e Shërbimit (rojet)** me detyrat përkatëse:

- Të ketë **drejtues teknik të licënsuar** për ushtrim aktiviteti.

Në bazë të ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” drejtuesi teknik i SHPSF-së, ndër të tjera kryen këto detyra:

a) harton rregullat e funksionimit të SHPSF-së, në lidhje me ruajtjen e objektit;

b) është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje;

c) ka përgjegjësinë të konstatojë dhe të analizojë të metat e dobësitë e punonjësit të shërbimit, t'ua bëjë ato të njohura administratorit dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit, si dhe të marrë masa për shmangien dhe përmirësimin e tyre;

ç) jep masa disiplinore ndaj punonjësit të shërbimit, sipas kuptimit të këtij ligji;

d) parandalon planifikimin në shërbim të punonjësit të papajisur me uniformë, armatim dhe pajisje shërbimi;

dh) merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes, në rastin kur ndodh një vepër penale në territorin e objektit që ka në ruajtje, duke njoftuar Policinë e Shtetit dhe duke bashkëpunuar me të.

Specifikimet për punonjësit e shërbimit(rojet), referuar Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”

- Të jenë të aftë fizikisht;
- Të jenë të licencuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut;
- Të jenë të pajisur me uniformë të rregullt (në bazë të nenit 23, të ligjit nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit, si dhe në uniformë duhet të vendosen, sipas përkatësisë, shenjat dalluese, emblemat, stemat, numri identifikues, të cilat tregojnë identitetin e subjektit dhe të punonjësit të shërbimit);
- Të jenë të pajisur me radio komunikim, i cili duhet të jetë i lidhur me sistemin qëndror të komunikimit me radio;
- Të ketë libër planizimi për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit;
- Të kenë të drejtën e mbajtjes e përdorimit të armëve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të kenë leje për armë;
- Të zbatojnë me korrektësi detyrat për ruajtjen e objekteve spitalore, godinave teknike të gazrave mjekësore dhe lëndës djegëse, godinës së farmacisë qëndrore dhe depove përkatëse të saj, farmacive periferike, godinën e telemjekësisë, sipërfaqeve të gjelbërta dhe bimësisë, si dhe ruajtjen e të gjithë territorit të QSUT-së, si sipërfaqet e gjelbërta nga ndotjet, dëmtimet, vjedhjet apo abuzimet e tjera të mbajë lidhje të vazhdueshme me drejtuesin teknik;
- Të zbatojnë me korrektësi detyrat për, zbatimin e orarit të vizitave në pavion/godinat spitalore, dhe të moslejimit të qytetarëve për kryerjen e konsultave ambulatorë në pavion, përveç Godinës së Qendrës së Konsultave, Godina e Konsultave e Neuroshkencës, Godina e Konsultave të Neurologjisë, Godina e Konsultave e Pediatriisë, Godina e Konsultave Spitalit Francez.
- Të zbatojnë rregulloren e brendshme të miratuar;
- Të zbatojnë me korrektësi cdo urdhër të titullarit të A.K., apo kërkesë të dalë prej A.K.
- Të mbajnë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
- Të kryejnë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron;
- Të mos vendosin në uniformë dhe në mjetet e transportit simbole apo shenja të tjera, përveç atyre të miratuara nga ky ligj;
- Të kenë kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe të mos përdorë pije alkoolike, droga e lëndë narkotike në shërbim.

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Pasqyra e mbulimit me roje private të objekteve dhe godinave spitalore, godinave teknike, godina e telemjekësisë, sipërfaqeve të gjelbërta dhe bimësisë, në territorin e Q.S.U.T. për vitin 2017

Nr	Shërbimi	Koefiçienti i mbulimit	Mbulimi me roje i objekteve		
			turn i I	turni II	turni III
1	Ndërtesa e Drejtorisë	4.83	1	1	1
2	Spitali 6 katësh	4.83	1	1	1
3	Shërbimi i Toksikologjisë	4.83	1	1	1
4	Kardio - Kirurgjia	4.83	1	1	1
5	Kirurgjia Klinika e parë	4.83	1	1	1
6	Kirurgjia Kl. II (Urologjia) + Kl. III (Digjестive)	4.83	1	1	1
7	Urgjenca Kirurgjikale	4.83	1	1	1
8	Urgjenca e Sëmundjeve të Brendëshme	4.83	1	1	1
9	Reanimacioni Qëndror + Mjekësia Interne	4.83	1	1	1
10	Hyrja kryesore e Spitalit të Neurokirurgjisë	4.83	1	1	1
11	Spitali i Neurokirurgjisë	1.61	1	0	0
12	Spitali i Neurologjisë	1.61	1	0	0
13	Hyrja Kryesore e Sp të Psik. + Aksil. Neurokir. + Urgj. e Psik. + Psik. Infantile	4.83	1	1	1
14	Spitali Infektiv	4.83	1	1	1
15	Spitali Onkologjik	4.83	1	1	1
16	Radio - Terapi Onkologjiku	4.83	1	1	1
17	Spitali Francez	3.22	1	0	1
18	Spitali Djegie Plastikës+ Dermatologji	3.22	1	0	1
19	Spitali Pediatrikë së Specialiteteve	4.83	1	1	1
20	Pediatria e Përgjithshme	4.83	1	1	1
21	Qendra e Konsultave Ambulatore	1.61	1	0	0
	Numri Total i Rojeve	88.55			

Godinat e listuara më sipër, janë përcaktuar nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, sipas nevojave për roje në godinat spitalore dhe territorin e QSUT-së. Çdo godinë e spitalit kontrollohet nga një vendroje, e cila mbulohet me rojet përkatëse sipas turneve.

Afatet e ekzekutimit: nga data e nënshkrimit deri në datën 31.12.2017

Perlllogaritja e Fondit Limit është bërë për 304 dite.

TERMAT E REFERENCËS

PREVENTIV I SHPENZIMEVE PER 1 ROJE NE MUAJ me tre turne (turni I, II dhe III)

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve	Çmimi/Lekë
1	Paga bazë per nje punojes sherbimi	
2	Shtesë për sherbime	
3	Shuma (1 + 2)	
4	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	
5	Shuma (3 + 4)	
6	Shpenzime për ndërlidhje	
7	Shpenzime për Uniformën	
8	Shpenzime administrative	
9	Fitimi i llogaritur	
10	Shuma ne muaj per nje roje (5+6+7+8+9)	
11	Numri i vendrojeve	
12	Shuma per 304 dite kalendarike	
13	TVSH	
14	TOTAL	

Public Health Sector

PREVENTIV I SHPENZIMEVE PER 1 ROJE NE MUAJ me dy turne (turni I dhe III)

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve	Çmimi/Lekë
1	Paga bazë per nje punojes sherbimi	
2	Shtesë për sherbime	
3	Shuma (1 + 2)	
4	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	
5	Shuma (3 + 4)	
6	Shpenzime për ndërlidhje	
7	Shpenzime për Uniformën	
8	Shpenzime administrative	

9	Fitimi i llogaritur	
10	Shuma ne muaj per nje roje (5+6+7+8+9)	
11	Numri i vendrojeve	
12	Shuma per 304 dite kalendarike	
13	TVSH	
14	TOTAL	

PREVENTIV I SHPENZIMEVE PER 1 ROJE NE MUAJ me nje turne (turni I)

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve	Çmimi/Lekë
1	Paga bazë për një punojës shërbimi	
2	Shtesë për shërbime	
3	Shuma (1 + 2)	
4	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	
5	Shuma (3 + 4)	
6	Shpenzime për ndërlidhje	
7	Shpenzime për Uniformën	
8	Shpenzime administrative	
9	Fitimi i llogaritur	
10	Shuma ne muaj per nje roje (5+6+7+8+9)	
11	Numri i vendrojeve	
12	Shuma per 304 dite kalendarike	
13	TVSH	
14	TOTAL	

Personeli i ngarkuar në shërbim, i vendosur në vendrojet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duhet të zbatojë me rigorozitet **TERMAT E REFERENCËS**, si më poshtë:

- Rregulloren e Brëndshme të QSUT-së (përfshi këtu të shërbimeve);
- Rregulloren e Brëndshme mbi shërbimin e rojeve për ruajtjen dhe sigurimin e objektit të QSUT-së;
- Të Respektojë orarin e vizitave të miratuara, pjesë të rregullores, në të gjitha godinat spitalore, ku : të mos lejojë asnjë hyrje – dalje të familjarëve në pavione, përveç gjatë orarit të vizitave të miratuara, dhe vetëm nga një person për familjar dhe jo prezencën e fëmijëve nën 16 vjeç;
- Të sigurojë gjithashtu, që gjatë orarit të vizitave, të mos lejojnë hyrjen e çantave të mëdha, valixheve në dhomën e pacientit;

- Të sigurojë të gjitha godinat spitalore, dhe përreth territorit të tyre sipas vendrojeve të përcaktuara në tabelë.
- Të sigurojë objektet e tjera, pjesë e territorit të QSUT-së, ku përvec godinave spitalore janë të rëndësishme në QSUT, si : farmacitë periferike, farmacinë qendrore, depot e QSUT-së, tankerat e oksigjenit, depon qendrore të ujit, depon qendrore të kaldajës, motogjeneratorët, depot teknike, magazinën e konsumit, magazinën e inventarit, godinën e telemjekësisë, mjetet e transportit të QSUT-së (ambulancat), shtyllat e larta të ndricimit, si dhe ndricimin e eulët pjesë e territorit të QSUT-së, sipërfaqet e gjelbërta, pemët dhe bimësisinë që gjendet në të;
- Të sigurojë, mos lejin e asnjë personi apo personeli të paautorizuar nga Drejtoria, në të gjitha godinat spitalore dhe jo spitalore, përveç personave të stafit të administratës, teknik, shëndetësor, mjekëve specializantë, të cilët: vetëm nëse do të jenë të pajisur me dokument identifikues të Drejtorisë së QSUT-së mund të aksesojnë hyrjen;
- Të sigurojë, mosdëmtimin e sipërfaqeve të gjelbërta të territorit të QSUT-së dhe të pemëve dhe bimësisë që gjendet në të, të cilat mirëmbahen nga operatorë të kontraktuar, të cilat do i lihen me proces verbal në momentin e lidhjes së kontratës;
- Cdo ditë në orën 22:00 në pavionet mjekësore, personeli në shërbim duhet të mbyllë derën kryesore të godinës ku kryen shërbimin, dhe të kontrollojë të gjitha dyert e pavioneve apo dyerve të tjera në shërbim, duke marrë konfirmimin e personelit infermioror përgjegjës të turnit dhe mbylljen e dritave, si dhe të sigurojë moslejin e personave të paautorizuar gjatë gjithë kohës;
- Të mos lejojë parkimin e mjeteve para hyrjes kryesore të godinave spitalore, si dhe të ruajë sipërfaqet e parkimit të QSUT-së;
- Të mbështesë gjithmonë personelin infermioror sa herë që kërkon ndihmë;
- Gjatë gjithë kohës personeli që është në shërbim, përveç veshjes duhet të mbajë dokumentin e identifikimit;
- Të komunikojë me etikë si me qytetarët, pacientët ashtu dhe me personelin infermioror gjatë gjithë kohës së shërbimit, dhe mos të japë informacion të paautorizuar.
- Është e rëndësishme që në QSUT, brenda numrit të rojeve herë pas here të krijohet një patrullë në qarkullim, e cila do qarkullojë gjatë gjithë kohës në territorin e QSUT-së, për t'iu përgjigjur të gjitha problematikave që hasen në shërbimet spitalore, si dhe për të mos lejuar ambulatorë të ndryshëm, lypsarë, etj;
- Gjithashtu, ti bëhet prezente firmës kontraktuese, që nëse konstatohet prezenca e vizitorëve jashtë orarit zyrtar të vizitave në pavione apo holle, qoftë dhe një herë të vetme, kur kjo është e dokumentuar me procesverbalet përkatëse, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të prishë kontratën;
- Të mos lejojnë në mënyrë kategorike, hyrjen e agjensive private funerale brenda shërbimeve spitalore.